



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
Kompania Regjionale e Mbeturinave/ Regional waste Company/ Regionalna Kompanija za Uklanjanja Otpada

**KRM "PASTËRTIA" SH.A. FERIZAJ**

Rr. "Enver Topalli" Nr. 47 Tel. 0290/325-025



DATE	24.02.2023
PËR	Punëtorët e KRM "Pastërtia" Sh.A në Njësinë-Qendër Ferizaj dhe Njësitë Shtime dhe Kaçanik
NGA	Kryeshefi Ekzekutiv i KRM "Pastërtia" Sh.A Ferizaj
LËNDA	<u>NJOFTIM: PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR SINJALIZIM TË BRENDSHËM në KRM "Pastërtia" Sh.A</u>

Njoftohen të punësuarit e KRM "Pastërtia" Sh.A - Kompanisë Regjionale të Mbeturinave në Ferizaj dhe Njësitë e saja në Shtime dhe Kaçanik, se duke u bazuar Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Zyrtare Përgjegjëse për Sinjalizim të Brendshëm në KRM "Pastërtia" Sh.A është caktuar Diellza REÇICA (në punë dhe detyra të punës Zyrtare Ligjore), e cila njëherit është pikë kontakti për sinjalizimin e shkeljeve në Kompani.

Qëllimi i caktimit të Zyrtarit Përgjegjës për sinjalizim të brendshëm është mundësimi i sinjalizimit të shkeljeve në sektorin publik në rastet kur: shkelja është kryer, është duke u kryer apo ka gjasa të kryhet; personi ka dështuar, është duke dështuar ose ka gjasa të dështoj të përmbush ndonjë detyrim ligjor, ka ndodhur; është duke ndodhur ose ka gjasa të ndodhë keqadministrimi i drejtësisë; shëndeti apo siguria e individit është rrezikuar, është duke u rrezikuar ose ka gjasa të rrezikohet; mjedisi është dëmtuar, është duke u dëmtuar ose ka gjasa të dëmtohet; ka pasur keqpërdorim të detyrës zyrtare apo autoritetit të parave publike ose resurseve të një institucioni publik; një veprim apo mosveprim nga ose në emër të një institucioni publik është diskriminues, shtypës, kryhet nga pakujdesia ose përbën keqmenaxhim të rëndë; informacioni që synon të tregojë ndonjë nga çështjet që bien në ndonjë nga nënparagrafët e mësipërm ka qenë, është ose ka gjasa të jetë fshehur ose shkatërruar; Raportimi apo shpalosja do të supozohet se është në interes publik, përveç nëse vërtetohet e kundërta, kjo është duke ndodhur ose ka gjasa të ndodhë; në këtë rast të shkeljeve në kuadër të KRM "Pastërtia" Sh.A - Kompanisë Regjionale të Mbeturinave në Ferizaj dhe Njësitë e saja në Shtime dhe Kaçanik.

KRM "Pastërtia" Sh.A. Ferizaj  
Kryeshefi Ekzekutiv

BASRI SULA

